


Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University			
Pranuar nga data: 29.12.2020			
Niveli Organizativ:	Numer:	Str. tit.	Str. nr.
	01	2480	



MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

NË MES

UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" (UP)

DHE

UNIVERSITETIT PUBLIK "KADRI ZEKA" (UKZ)

- Bazuar në Marrëveshjen nr. 01/531 të datës 13.05.2015 ndërmjet MASHT, Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit "Kadri Zeka" në Gjiilan, sipas të cilës, UP-ja do të ndihmojë UKZ në fushat akademike dhe shkencore sipas kërkesës me shkrim nga UKZ drejtuar UP (neni 10.5 e Marrëveshjes).
- Bazuar në misionin e Qendrës për përsosmëri në mësimdhënie (QPM) të UP-së për të siguruar avancim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm në mësimdhënie, në shërbime inovative dhe për të promovuar kulturën e përsosmërisë në mësimdhënie në UP dhe në institucionet e tjera të arsimit të lartë (IAL).
- Në bazë të përgjegjësiave për punë efektive dhe menaxhim të politikave të zhvillimit të universitetit (neni 25.2. i statutit të UKZ-së), dhe me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënësve të UKZ-së (neni 190.1 i Statutit të UKZ).
- Dhe me kërkesë të Rektorit të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjiilan, për fillimin e procesit të trajnimit të personelit akademik të UKZ-së në QPM të UP-së, u pajtuan si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi ka për qëllim të rregulloj mundësinë e trajnimit të personelit akademik të UKZ në Gjiilan, në Qendrën për Përsosmëri në Mësimdhënie (QPM) të UP, për të siguruar përsosmëri në mësimdhënie dhe avancimin e aftësive dhe kompetencave të personelit akademik të UKZ.

Neni 2

Fushëveprimi

Palët në këtë marrëveshjeje janë pajtuar plotësisht që:

1. Qendra për përsosmëri në mësimdhënie (QPM) e UP-së, do të ofrojë trajnime në nivelin bazik dhe të avancuar për personelin akademik të UKZ.
2. Universiteti publik “Kadri Zeka” në Gjiilan, përcakton listën e personelit akademik që do të jenë pjesëmarrës në trajnimet e organizuara nga QPM e UP-së.

Neni 3

1. Trajnimet e personelit akademik të Universitetit “Kadri Zeka”, mbahen në hapësirat e parapara, ose në mënyrë virtuale, sipas orarit dhe aktiviteteve të përcaktuara nga QPM e UP-së.
2. Personeli akademik i UKZ janë të obliguar të ndjekin të gjitha sesionet e planifikuara në kuadër të trajnimeve të organizuara nga QPM e UP-së.

Neni 4

Certifikimi

1. Vlerësimi i performancës së personelit akademik të UKZ-së gjatë zhvillimit të trajnimeve nga QPM e UP-së bëhet në pajtim me rregulloret e përcaktuara nga QPM.
2. QPM obligohet që për personelin akademik të UKZ, të cilët kanë përfunduar me sukses trajnimet t'i pajis me certifikatë të QPM të UP-së .

Neni 5

1. Qendra për përsosmëri në mësimdhënie paraqet koston e trajnimit për secilin kurs/modul trajnimi.
2. Kandidatët për trajnime nga personeli akademik i UKZ-së janë të obliguar të mbulojnë shpenzimet financiare për trajnim, të cilat mund të mbulohen nga UKZ, nëse UKZ e sheh të arsyeshme.

Neni 6

1. Menaxhimi i kalendarit të zhvillimit të trajnimeve për personelin akademik të UKZ-së, bëhet në bashkëpunim, ndërmjet Këshillit të trajnimeve të QPM dhe menaxhmentit të UKZ.
2. Mbulimi i shpenzimeve për të cilat UKZ e konsideron të nevojshme, mund të bëhet me marrëveshje shtesë mes UP dhe UKZ.

Neni 7

Ndryshimi, plotësimi dhe përfundimi i marrëveshjes



1. Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj marrëveshjeje mund të bëhet me pajtimin e të gjitha palëve nënshkruese.
2. Ndryshimet dhe/ose plotësimet duhet të jenë pjesë-shtojcë e kësaj marrëveshjeje.
3. Kjo marrëveshje vlen për afat të pacaktuar por mund të përfundoj me kërkesë të njëjës palë, për të cilën pala tjetër duhet të njoftohet së paku 30 ditë më parë.

Neni 8

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.
2. Marrëveshja nënshkruhet në gjashtë (6) kopje identike, nga dy (2) kopje për UP, dy (2) kopje për qendrën QPM dhe dy (2) kopje për UKZ.

Nënshkruar në Prishtinë, Republika e Kosovës me 28 dhjetor 2020

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Prof. Dr. Naser Sahiti , Rektor	Universitetit "Kadri Zeka" Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi , Rektor
 Nënshkrimi dhe vula	 Nënshkrimi dhe vula